



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 2093/3 prot.

Tiranë, më 10.10.2025

**VENDIM**

**Nr. 33, datë 10.10.2025**

**PËR**

**URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

**KONSTATOVA SE:**

Ankuesi z. (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) formularin e ankesës me nr. 2039 prot., datë 14.08.2025, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik/Autoriteti Rrugor Shqiptar (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, me anë të kërkesës për informacion, të depozituar pranë Autoritetit Publik me nr. 7191 prot., datë 31.07.2025, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni, për vitin 2024 në lidhje me:

1. *Dokumentacionin administrativ dhe teknik në lidhje me projektin: “Zgjerimi i superstradës Tiranë – Durrës (Loti 1) – Faza III”.*

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji, konkretisht, urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion datë 31.07.2025.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”). Në vijim të procedurës së shqyrtimit administrativ në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në*

*procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Zyra e Komisionerit me datën 15.08.2025, ka kontaktuar në mënyrë telefonike me koordinatorin për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, duke u informuar mbi trajtimin, apo procedurën e ndjekur, lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Koordinatori për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, informoi Zyrën e Komisionerit se ishte përgatitur përgjigja ndaj ankuesit, e cila do t'i dërgohej elektronikisht dhe në mënyrë shkresore, ankuesit dhe Zyrës së Komisionerit brenda datës 22.08.2025.

Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës nr. 7191/2 prot., datë 21.08.2025, i ka kthyer përgjigje ankuesit duke e sqaruar se: *“...dokumentacioni administrativ dhe teknik në lidhje me projektin: “Zgjerimi i superstradës Tiranë – Durrës (Loti 1) – Faza III”, ju informojmë se dokumentet përkatëse janë tashmë të publikuara dhe të aksesueshme publikisht në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik (www.app.gov.al)...”*

Ankuesi ka vijuar ankimin e tij nëpërmjet ankesës së datës 27.08.2025, rregjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2039/1 prot., datë 27.08.2025. Pas vijimit të ankimit, Zyra e Komisionerit ka kontaktuar sërish me koordinatorin për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, i cili ka informuar Zyrën e Komisionerit se ishte përgatitur një përgjigje e dytë përfundimtare nga ana e Autoritetit Publik. Ankuesi ishte ftuar pranë ambienteve të Autoritetit Publik, ku dhe ishte sqaruar për kërkesat e parashtruara në kërkesën për informacion të datës 31.08.2025, si dhe duke na vendosur në dispozicion shkresën 8366/1 prot., datë 25.09.2025. Në vijim të komunikimit, Zyra e Komisionerit ka kontaktuar me ankuesin në lidhje me ankimin e tij.

Pas komunikimit me Zyrën e Komisionerit, ankuesi nëpërmjet e-mail-it, datë 03.10.2025, rregjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2039/2 prot., datë 06.10.2025, ku ndër të tjera sqaron se: *“...në shkresën nr. 8366/1 prot., datë 25.09.2025 është deklaruar nga Autoriteti Publik se jam ftuar në ambientet e institucionit (A.Rr.Sh.), dhe më është kthyer përgjigje për të gjitha kërkesat e ngritura...ende sot nuk kam marrë dokumentacionin e kërkuar në format elektronik nga Autoriteti Rrugor Shqiptar...”*

Në këto rrethana, pas shqyrtimit të objektit të ankimit si dhe konsultimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2 të LDI, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”.

Pika 2 dhe 3 të nenit 14 të LDI përcaktojnë se: *“2. Kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuarit: a) një kopje të plotë, në format të njëjtë me atë të përdorur nga autoriteti publik, përveç rasteve të veçanta; b) një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet. 3. Lidhur me kërkesat që lidhen me forma të tjera, informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.”*

Bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisë të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”*.

Në kuptim të këtij parashikimi, Autoriteti Rrugor Shqiptar është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundur realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e “prodhuesit” apo “mbajtësit” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.*

Konstatohet se, Autoriteti Publik nuk ka argumentuar lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar bazuar në kufizimet që parashikon neni 17 i LDI. Në çdo rast, duke qenë se informacioni i kërkuar lidhet me investime të rëndësishme në infrastrukturë të cilat prekin drejtpërsëdrejti qytetarët, interesi publik për të aksesuar dokumentacionin e kërkuar, në këtë rast është i drejtëpërdrejtë dhe tejte i lartë.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni i kërkuar, në parim përbën informacion publik bazuar në pikën 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilës: *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”*. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse është prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të këtij ligji, i cili parashikon: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

## V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së z. \_\_\_\_\_, me nr. 2039 prot., datë 14.08.2025, ndaj Autoritetit Publik, Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 31.07.2025, konkretisht: “*Dokumentacionin administrativ dhe teknik në lidhje me projektin: “Zgjerimi i superstradës Tiranë – Durrës (Loti 1) – Faza III”*”, brenda datës 17.10.2025.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 10.10.2025.

## KOMISIONERI

**Besnik Dervishi**